

<http://www.levurelitteraire.com/0NUMERO4/TEXTES/pavol5.htm>

PAVOL JANIK

(Sllovakë)



Magjister, PhD, **Pavol Janik**, President i Shoqatës së Shkrimtarëve Sllovakë, fitues i shumë çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, poet, romancier, dramaturg.

Shqipëroi **Riza Lahi**

E ÇUTITËSHME

Unë zmadhoj ujët
Ku ke reflektuar fytyra jote
Dhe me një të bërtitur
E ndaloj që të mos derdhet

Të drejtohem ty me frymë
Pa asnjë fjalë, vetëm me frymë
Përderisa ti je një qelqe me akull
para gllënkës.

Të dridhurat të pandalura nën syprinën e
mpirjes tënde
dhe në fund për një moment llaps
ja pse po pres ditën
kur do të jesh e tëra zjarr

TEATRI I JETËS

Jeta s'është tjetër, veç shfaqje teatri
një shfaqje që duam ta luajmë gjithmonë
Kur jemi në qejf, kostum e kollare

a s'i ndërrojmë me rrobot e kllounit?

Vrapon jeta, rend, nga lluca në pellg
me ne sillet jeta si të jetë lavjerrës
këtë e di mirë, e ka provuar çdo brez
siç ka qënë s'bëhet më jeta asnjëherë

Një gotë e mbushur pëplot është jeta
që derdhet nga pak, përditë, në çdo vënd;
poshtë thembrave tona, çfar derdhet ndalon
poshtë thembrave tona duam të kemi dikënd

Janë arna në perde ...janë arna dhe shpirti....
Në fund të vjen vdekja – shahmat loja jote
Po prap meriton të luhet kjo lojë
Ji i gëzuar ...në fund të fundit , ti rrojte

Ka gjetur kjo jetë në skenë një pasqyrë —
Ajo vjen e gjallë me të ditpërditë.
Nëse ty diçka të tundon në teatër
Lëviz drejt kohëve antike

Rri mirë, rregullohu në fronin tënd bosh
Mësoji me zemër ti çastet e jetës
Nëqoftëse gogësin gjatë shfaqjes së saj
Atëherë ...shiko, kthe paret e biletës

NJU JORK

Në një pasqyrë të rrafshët
Të gjirit të pispillosur
Shënjat e një qyteti kockëdalë
Që I ngul thikën qiellit të shëndritshëm

Në detin e shëndritëshëm të llampave
Duke këkruar flirt lëvrijnë varkat
Fërgëllojnë mahnitëshëm

Në këmbët e tua të shqetësuar
duke lundruar në ultësirën e kuvertës

së një brocade me veshjen e mbrëmjes

Papritur, të humbet tjetri
Si gjilpëra në kashtë

Diçka kemi marrë me vete—
zgjatin lumuzinat
lodrojnë ketrushët në “Central Park”
dhe trupi i metaltë i lirisë së vdekur.

Në Nju Jork gjithçka të bëhet lëmsh

Mbrëmjet e shëndritëshme llapsin.

Shkëlqen njëmijë armëshi i mega qytetit
Shkruan mesazhi i Ajnshtajnit rreth
shpejtësisë së dritës
çdo mbrëmje nëpër llapsien e sipërfaqes së
ujit.

Dhe sërish përpara muzgut
përbushet ekrani i argjentë
i qiellit të Nju Jorkut
me hektolitrat e gjakut të Hollivudit
Deri ku arrin perandoria e xhamave dhe
mermereve?

Deri ku nishani i raketave të larta të
grataçieleve?

Zoti blen një “hot dog”
Poshtë një rrugë gjashtëdhjetë katëshe

Zoti është një zezak
Që dëshëron kolorin gri të konkretes

Dielli i tij ka lindur prej tij vetë
në një kuti kartoni
nga lloji më i ri i skllavit

ENGJËLLI DALLOHET NGA PENDËT

(Për prindërit e mi, që kanë shkuar, që s'janë më)

Në thellësitë e intimiteteve të mia shfaqen
skelete
dhe e gjithë memoria ime e qelqët dridhet.

Në fund të heshtjes për të dëgjuar shiun e
vitit që shkoi
se si ai diktonte pëshpëritje
— Telegrami i tij i pakuptueshem:
Një grup engjëjsh të trishtuar
po rënkojnë nën ndriçimin e e hënës.

Lumi - drejt theqafjes nga mërzia,
shpirti që po vdes i ujit
gremiset teposhtë
për te shtrati i tij i qetë.

Ndjej mëshirë
pas eksplozionit të gjakut
— kanë hyrë nëpër venat e mia
ëngjëjt supersonikë
ardhur nga të vdekurit.

Motorrat e tyre shurdhonyes
fillojnë që në trurin tim.

Kur ata ngrihen
nis qetësia më e thellë
gjatë së cilës më bëhet se dëgjoj
se si ata derdhen nëpër parket
perlat e distancës

Shfaqja e mëngjesit me loë të ngrirë
nguros në sytë e mi
që ende kanë kaq vjeshtë.

Shqipëroi **Riza Lahi**